

BGP SouthEastEurope sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
L81420018U

BGP Southeast Europe Shpk
NIPT: L81420018U
Rr. Shemsí Haka, Tiranë - Albania

PERMBAJTJA:

| | FAQE |
|--|------|
| COVER | 1 |
| PERMBAJTJA | 2 |
| PASQYRAT FINANCIARE: | |
| PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR | 3 |
| PASQYRA E PERFORMANCES | 4 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL | 5 |
| PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE | 6 |
| SHENIMET SHPJEGUSE TE PASQYRAVE FINANCIARE | 7-23 |

BGP Southeast Europe Shpk

NIPT: L81420018U

Rr. Shemsi Haka, Tiranë - Albania

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2019

| | Shënim e | 31 dhjetor 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|---|-------------|-------------------|-------------------|
| AKTIVE | | | |
| Aktive afatshkurtra | | | |
| Mjete monetare | 5 | 4,511,342 | 21,113,060 |
| Llogari të arkëtueshme | 6 | 3,639,363 | - |
| Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura | 7 | 742,079 | 41,804,947 |
| Të tjera të arkëtueshme | 8 | 9,722,612 | 1,331,954 |
| Parapagime dhe shpenzime të shtyra | 9 | 635,754 | 183,020 |
| Garanci qiraje | 10 | 391,320 | 391,320 |
| Totali i aktiveve afatshkurtra | | 19,642,470 | 64,824,301 |
| Aktivet afatgjata | | | |
| Aktive afatgjata materiale | 11 | 1,967,493 | 1,486,374 |
| Totali i aktiveve afatgjata | | 1,967,493 | 1,486,374 |
| Totali i aktiveve | | 21,609,963 | 66,310,675 |
| DETYRIMET | | | |
| Detyrime afatshkurtra | | | |
| Llogari të pagueshme tregtare | 12 | 8,593 | 217,795 |
| Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura | 13 | 1,436,885 | 728,178 |
| Detyrime tatimore | 14 | 2,566,483 | 4,087,832 |
| Të tjera detyrime | 15 | - | 112,586 |
| Totali i detyrimeve afatshkurtra | | 4,011,961 | 5,146,391 |
| Detyrime afatgjata | | | |
| Totali i detyrimeve afatgjata | | - | - |
| Totali i detyrimeve | | 4,011,961 | 5,146,391 |
| Kapitali | | | |
| Kapitali i nënshkruar | | 6,617,500 | 6,617,500 |
| Fitimi i ushtrimit | | 10,980,502 | 54,546,784 |
| Totali i kapitalit | 16 | 17,598,002 | 61,164,284 |
| Totali i kapitalit dhe detyrimeve | | 21,609,963 | 66,310,675 |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 18 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

| | Shënim e | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 | Për periudhën 16 shkurt deri më 31 dhjetor 2018 |
|---|-------------|---|--|
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 17 | 91,204,716 | 101,544,770 |
| Total të ardhura | | 91,204,716 | 101,544,770 |
| Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime | | (29,866,579) | (9,625,405) |
| Të tjera shpenzime | 18 | (29,866,579) | (9,625,405) |
| Shpenzime të personelit | 19 | (49,109,815) | (32,513,896) |
| 1) Paga dhe shpërblime | | (44,749,616) | (29,786,936) |
| 2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore | | (4,360,199) | (2,726,960) |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 11 | (530,129) | (283,510) |
| Shpenzime financiare | | (135,765) | (1,704,292) |
| Shpenzime të tjera financiare | 20 | (135,765) | (1,704,292) |
| Fitimi/humbja para tatimit | | 11,562,428 | 57,417,667 |
| Shpenzimi i tatimit mbi fitimin | | (581,926) | (2,870,883) |
| Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin | 21 | (581,926) | (2,870,883) |
| Fitimi/humbja e vitit | | 10,980,502 | 54,546,784 |
| Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin | | - | - |
| Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin | | 10,980,502 | 54,546,784 |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BGP SOUTHEAST EUROPE sh.p.k
(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

| Pozicioni financiar më 16 Shkurt 2018 | Kapitali i nënshkuar | Dividendë të paguar | Fitim / Humbja e vitit | Totali |
|--|----------------------|---------------------|------------------------|-------------------|
| Emetim i kapitalit të nënshkuar Fitim/Humbja e vitit | 6,617,500 | - | - | 6,617,500 |
| Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018 | 6,617,500 | - | 54,546,784 | 61,164,284 |
| Fitim/Humbja e vitit | | | 10,980,502 | 10,980,502 |
| Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital: | | | | |
| Transferim në fitime të mbartura | | 54,546,784 | (54,546,784) | - |
| Dividendë të paguar | | (54,546,784) | | (54,546,784) |
| Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019 | 6,617,500 | - | 10,980,502 | 17,598,002 |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratori i BGP SOUTHEAST EUROPE sh.p.k më 30/10/2020 dhe janë firmosur si më poshtë:



Z. Paolo Catona

Z. Paolo Catona
Përfaqësues ligjor

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

| Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 | Për periudhën 16 shkurt deri më 31 dhjetor 2018 |
|---|---|--|
| Flukset e parasë nga aktivitetet operative | | |
| Fitim / Humbja e vitit | 10,980,502 | 54,546,784 |
| Rregullimet për shpenzimet jomonetare: | | |
| Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar | - | 2,870,883 |
| Shpenzime amortizimi | 530,129 | 283,510 |
| Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit: | | |
| Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera | 29,032,847 | (43,136,901) |
| Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme | 386,919 | 945,973 |
| Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra | (452,734) | (574,340) |
| Rritje/(rënie) në detyrimet tatimore | (1,521,348) | 1,216,949 |
| Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit | - | 112,586 |
| Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit | 38,956,315 | 16,265,444 |
| Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit | | |
| Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale | (1,011,250) | (1,769,884) |
| Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit | (1,011,250) | (1,769,884) |
| Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit | | |
| Arkëtime nga emetimi i kapitalit themeltar | - | 6,617,500 |
| Pagesë dividendësh | (54,546,783) | - |
| Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit | (54,546,783) | 6,617,500 |
| Rritje/rënie neto të mjeteve monetare dhe ekuivalente me to | (16,601,718) | 21,113,060 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim | 21,113,060 | - |
| Mjetet monetare në fund të periudhës | 5 4,511,342 | 21,113,060 |

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

BGP SOUTHEAST EUROPE sh.p.k (Kompania) me NIPT L81420018U është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 16 shkurt 2018 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më datë 20 shkurt 2018 në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Shoqëria ka për objekt konsulence inxhinjerie të teknologjisë së informacionit, krijim dhe zbatim i software (programe) dhe platformave SAP dhe JAVA për kompani brenda dhe jashtë vendit si dhe kryerjen e çdo aktiviteti të ngjashëm në funksion të objektit kryesor.

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në rrugën Shemsi Haka, Pallati MATRIX, kati i parë, Tiranë.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 50,000 EUR dhe zotërohet nga IKons sh.p.k (49%), dhe BGP Management Consulting spa (51%).

Në 31 dhjetor 2019 shoqëria ka 28 punonjës. (2018 :24 punonjës)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, informacioni krahasues rregullohet në përputhje me ndryshimet në prezantim në periudhën aktuale të raportimit. Ndryshimet bëhen për të paraqitur më me drejtësi natyrën e biznesit. Ato zbatohen respektivisht.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

| Kursi i këmbimit | 31 dhjetor 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|-------------------------|------------------------|------------------------|
| EUR/ALL | 121.77 | 123.42 |
| USD/ ALL | 108.64 | 107.82 |

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiarë çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitet afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitet.

| Kategoria e aktiveve | Metoda e Amortizimit | Norma e Amortizimit |
|----------------------|----------------------|---------------------|
| Pajisje informatike | Vlera e mbetur | 25 % |

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.3. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

BGP Southeast Europe Shpk

NIPT: L81420018U

Rr. Shemsi Haka, Tiranë - Albania

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 5%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periodat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarje të kaluar, Kompania ka një detyrim ligjor ose konstruktiv aktual që mund të matet me besueshmëri, dhe ka të ngjarë që një rrjedhë e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar fluksin e ardhshëm të parave të gatshëm me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Provizionet shqyrtohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka indikacione për ndonjë rrjedhje të parave për shlyerjen e ndonjë detyrimi, provizionet rimerren.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Vlerësime kritike të kontabilitetit

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në Shoqëri. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, Shoqëria po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

(Vlerat janë në Lek)

5. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2019</u> | <u>31 dhjetor 2018</u> |
|---------------------------------------|------------------------|------------------------|
| Mjete monetare në bankë | 4,480,092 | 21,113,060 |
| Në lekë | 217,449 | 33,521 |
| Në monedhë të huaj | 4,262,643 | 21,079,539 |
| Mjete monetare në arkë në lekë | 31,250 | |
| | 4,511,342 | 21,113,060 |

6. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2019</u> | <u>31 dhjetor 2018</u> |
|---------|------------------------|------------------------|
| Klientë | 3,639,363 | |
| | 3,639,363 | - |

7. Llogari të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e arkëtueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2019</u> | <u>31 dhjetor 2018</u> |
|--|------------------------|------------------------|
| Të arkëtueshme tregtare -BGP Management Consulting SPA | 742,079 | 41,804,947 |
| | 742,079 | 41,804,947 |

8. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2019</u> | <u>31 dhjetor 2018</u> |
|--------------------------------|------------------------|------------------------|
| TVSH e arkëtueshme | 2,361,152 | 1,331,954 |
| Të arkëtueshme ndaj personelit | 527,654 | |
| Tatim Fitimi | 6,833,806 | |
| | 9,722,612 | 1,331,954 |

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2019</u> | <u>31 dhjetor 2018</u> |
|-------------------------------|------------------------|------------------------|
| Shpenzime të shtyra interneti | 180,833 | 183,020 |
| Parapagime ndaj punonjësve | 454,921 | |
| | 635,754 | 183,020 |

10. Garanci qiraje

Garancitë e dhëna më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|----------------------------|------------------------|------------------------|
| Garanci për qiranë e zyrës | 391,320 | 391,320 |
| | 391,320 | 391,320 |

11. Aktive Afatgjata Materiale

| | Pajisje informatike | Te tjera | Totali |
|-----------------------------------|--------------------------------|-----------------|------------------|
| Kosto | | | |
| Gjendja më 16 shkurt 2018 | | | - |
| Shtesa | 1,769,884 | | 1,769,884 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2018 | 1,769,884 | - | 1,769,884 |
| Shtesa | 976,248 | 35,000 | 1,011,248 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2019 | 2,746,132 | 35,000 | 2,781,132 |
| Amortizimi i akumuluar | | | |
| Gjendja më 16 shkurt 2018 | | | - |
| Amortizimi i vitit | 283,510 | | 283,510 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2018 | 283,510 | - | 283,510 |
| Amortizimi i vitit | 530,129 | | 530,129 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2019 | 813,639 | - | 813,639 |
| Vlera neto kontabël | | | |
| Gjendja më 31 dhjetor 2018 | 1,486,374 | - | 1,486,374 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2019 | 1,932,493 | 35,000 | 1,967,493 |

BGP Southeast Europe Shpk

NIPT: L81420018U

Rr. Shemsi Haka, Tiranë - Albania

(Vlerat janë në Lek)

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2019</u> | <u>31 dhjetor 2018</u> |
|------------------------------|------------------------|------------------------|
| Furnitorë në monedhë vendase | 8,593 | 64,014 |
| Furnitorë në monedhë të huaj | | 153,781 |
| | <u>8,593</u> | <u>217,795</u> |

13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2019</u> | <u>31 dhjetor 2018</u> |
|-------------------|------------------------|------------------------|
| Detyrime ndaj ARC | 1,436,885 | 728,178 |
| | <u>1,436,885</u> | <u>728,178</u> |

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2019</u> | <u>31 dhjetor 2018</u> |
|--|------------------------|------------------------|
| Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 981,024 | 663,200 |
| Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale | 1,585,459 | 553,749 |
| Tatim fitimi | | 2,870,883 |
| | <u>2,566,483</u> | <u>4,087,832</u> |

15. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

| | <u>31 dhjetor 2019</u> | <u>31 dhjetor 2018</u> |
|----------------|------------------------|------------------------|
| Paga personeli | | 112,586 |
| | <u>-</u> | <u>112,586</u> |

16. Kapitali

| | <u>31 dhjetor 2019</u> | <u>31 dhjetor 2018</u> |
|--------------------------|------------------------|------------------------|
| Vlera nominale (në EURO) | 25,000 | 25,000 |
| Numri i kuotave | 2 | 2 |
| | <u>50,000</u> | <u>50,000</u> |

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 50,000 EURO i zotëruar nga Ikons shpk (49%) dhe BGP Management Consulting spa (51%).

Fitimi i ushtrimit të shoqërisë ka vlerën 10,980,502 Lekë më 31 dhjetor 2019 (2018: 54,546,784 ALL).



17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe për periudhën 16 shkurt deri më 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 | Për periudhën 16 shkurt deri më 31 dhjetor 2018 |
|------------------------------------|---|--|
| Të ardhura nga shitja e shërbimeve | 91,204,716 | 101,544,770 |
| | 91,204,716 | 101,544,770 |

Rakordimi i të ardhurave me FDP:

| | 31 dhjetor 2019 |
|------------------------------|------------------------|
| Qarkullim i tatueshëm | 91,204,716 |
| Sipas Kontabilitetit | 91,204,716 |
| Diferenca | - |

18. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe për periudhën 16 shkurt deri më 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 | Për periudhën 16 shkurt deri më 31 dhjetor 2018 |
|------------------------------------|---|--|
| Shpenzime personeli jashtë njësisë | 21,850,416 | 4,334,561 |
| Shpenzime qiraje | 4,433,790 | 3,786,120 |
| Shërbime postare | 437,062 | 267,254 |
| Shpenzime transporti | 1,024,227 | 667,006 |
| Shpenzime energjie | 284,223 | 79,934 |
| Shpenzime bankare | 390,084 | 193,533 |
| Donacione për tërmetin | 306,575 | |
| Shpenzime të tjera | 1,140,202 | 296,997 |
| | 29,866,579 | 9,625,405 |

19. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe për periudhën 16 shkurt deri më 31 dhjetor 2018 si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 | Për periudhën 16 shkurt deri më 31 dhjetor 2018 |
|---|---|--|
| Shpenzime për paga | 44,749,616 | 29,786,936 |
| Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore | 4,360,199 | 2,726,960 |
| | 49,109,815 | 32,513,896 |

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2019 është 28 (2018: 24 punonjës).

20. Shpenzime të tjera financiare (neto)

Shpenzimet e tjera financiare (neto) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe për periudhën 16 shkurt deri më 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 | Për periudhën 16 shkurt deri më 31 dhjetor 2018 |
|-------------------------------|---|--|
| Humbje nga këmbimet valutore | 128,242 | 1,704,292 |
| Shpenzime të tjera financiare | 7,523 | |
| | 135,765 | 1,704,292 |

21. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe për periudhën 16 shkurt deri më 31 dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 | Për periudhën 16 shkurt deri më 31 dhjetor 2018 |
|---|---|--|
| <i>Fitimi para tatimit</i> | 11,562,428 | 57,417,667 |
| Total shpenzime të panjohura | 76,092 | |
| <i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i> | 11,638,520 | 57,417,667 |
| <i>Tatim fitimi @ 5%</i> | 581,926 | 2,870,883 |
| | 10,980,502 | 54,546,784 |

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri.

Shoqëria zhvillon vetëm veprimtari në fushën e teknologjisë së informacionit, në këto kushte në zbatim të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, "Për Tatimin mbi të Ardhurat", të ndryshuar dhe të VKM Nr. 730, date 12.12.2018 "Për përcaktimin e aktiviteteve që përfshihen në fushën e prodhimit/zhvillimit të software-ve, si dhe procedurat për aplikimin e tatimit fitimit nga personat juridikë që ushtrojnë këto aktivitete", shoqëria për vitin ushtrimor 2018 për aktivitetin që ka ushtruar në fushën e prodhimit/zhvillimit të software-ve ka aplikuar shkallën tatimore për Tatim Fitimin prej 5% sipas pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 8438, date 28.12.1998, të ndryshuar.

Në përputhje me kërkesat e seksionit II të VKM Nr. 730, datë 12.12.2018 shoqëria ka:

- përcaktuar në statutin e kompanisë si objekt veprimtarie, ndërmjet të tjerave, edhe aktivitetet ekonomike të parashikuara në pikën 2 të kreut I të VKM Nr. 730, date 12.12.2018
- ka në objektin e veprimtarisë vetëm aktivitete të teknologjisë së informacionit, që konsistojnë dhe lidhen direkt me prodhimin, tregtimin dhe eksport-importin e pajisjeve dhe sistemeve informatike e kompjuterike hardware dhe software
- ka paraqitur pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane një deklaratë me shkrim ka paraqitur aktivitetin e objekt-veprimtarisë së saj, për të cilat do të aplikojë shkallën tatimore 5%.

BGP Southeast Europe Shpk

NIPT: L81420018U

Rr. Shemsi Haka, Tiranë - Albania

(Vlerat janë në Lek)

22. Palët e lidhura

Balancat dhe transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2019 | | 31 dhjetor 2018 | |
|--------------------|--|-------------------|---|------------------|
| | Të arkëtueshme | Të pagueshme | Të arkëtueshme | Të pagueshme |
| ARC | | 1,436,885 | | 728,178 |
| BGP Management spa | 742,079 | | 41,804,947 | |
| | 742,079 | 1,436,885 | 41,804,947 | 728,178 |
| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 | | Për periudhën 16 shkurt deri më 31 dhjetor 2018 | |
| | Shitje | Blerje | Shitje | Blerje |
| Abkons | | | | 643,700 |
| ARC | | 8,719,787 | | 7,227,371 |
| Ikons | | | | 1,125,885 |
| BGP Management spa | 85,083,221 | 18,030,840 | 101,544,770 | |
| | 85,083,221 | 26,750,627 | 101,544,770 | 8,996,956 |

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura janë kryer me kushte tregtare dhe me çmime të përafërta me ato të tregut.

23. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 Dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

24. Ngjarje pas datës së bilancit

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi.

Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që volume i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Shoqëria gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndër marrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt.

Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 4 "Vlerësimet kritike të kontabilitetit" të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime kontabël ose shënime shpjeguese shtesë te pasqyrat financiare.